

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** “Mirëmbajtja e impiantistikës për Spitalin Rajonal Lezhë”.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):** 98341110-9, Shërbime mirëmbajtjeje

**Vlera e fondit limit:** 19,559,093.33 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëdhjetë e tre pike tridhjetë e tre) lekë pa TVSH

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas Shtojcës 9 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, ndryshuar me ligjin nr. 126/2024, datë 19.12.2024 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

**2.2.2** Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate shërbimi per te deshmuar pervojen e meparshme vlere totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

### 2.3.2 **Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

#### **Për punimet speciale të ndërtimit :**

- **NS-3A** Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- **NS-12A** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.
- **NS-14A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kategoritë e kerkuara janë kërkuar bazuar ne shërbimin qe do te realizohet sipas objektit te prokurimit. Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

| Kategoria e kërkuar | Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës                          | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse  | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive |
|---------------------|---|---|---|
| NS-3A               | Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues) | Mirembajtje e rregullt periodike e ashensorit te Maternitetit<br><br>Mirembajtje e rregullt periodike e ashensoreve te spitalit   | A<br>(0-20 milionë lekë)                                  |
| NS-12A              | Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.                            | Kontroll, shërbime teknike KALDAJE E SISTEMIT HVAC<br>Kontroll, shërbime teknike KALDAJE E UJIT TE NGROHTE SANITAR<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 3-Mujore në Pompën e Qarkullimit të Kaldajave<br>Përfshin kontrollin, mirëmbajtjen dhe verifikimin e plotë të pompës centrifugale horizontale me inverter<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 3-Mujore në Pompën e Qarkullimit – Kaldaja e Ujit të Ngrohtë<br>F.v. koka sprucatori 3,5x45 gradë<br>F.v. filtra naftë<br>F.v. leshues me rele termike 40 A (sprucat.kaldaje)<br>F.v. transformator tensioni bruçatori kaldaje 940 kË<br>F.v. tregues presioni<br>F.v. tregues temperature<br>F.v. llampa sinjalizimi<br>F.v. presostartër dhe termostartër për kaldajat<br>F.v. premistopë të ndryshëm sipas faktit<br>F.v. kushinata të pompave të ujit me nr.(sipas faktit)<br>Fv.salvamoto 4-6,3 A start stop50/60 Hz<br>Kontroll dhe shërbime teknike në POMPË NXEHTËSIE (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik)<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 6-Mujore – Akumulator Uji i Ngrohtë<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 6-Mujore – Pompat e Qarkullimit të Nxehtësisë (2 copë)<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 3-Mujore – Këmbyes Nxehtësie<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 6-Mujore – Pompa Qarkullimi AHU (Blloku Operator – Materniteti)<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 6-Mujore – Pompa Qarkullimi Fan Coil (Materniteti)<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 6-Mujore – Pompa Qarkullimi Fan Coil (Materniteti)<br>Kontroll dhe shërbime teknike në Pompë qarkullimi Fan Coil –Spitali POMPE QARKULLIMI (Linja 2)<br>Kontroll dhe Shërbime Teknike 3-Mujore – Njësi e Brendshme Fan Coil Dysheme<br>Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI e brendshme F.Coil Kanalor, • Kontrolli i funksionimit të ventilatorit dhe motorit<br>Kontroll dhe riparim ,zevendesim paketes elektronike dhe venie ne funksion Multisplit, ne funksion te Ambienteve Teknike Elektrike | A<br>(0-20 milionë lekë)                                  |

|  |   |  |
|--|---|--|
|  | <p>Kontroll i linjes per rrjedhjen e gazit dhe me pas mbushje me gaz dhe venie ne funksion Multisplit, ne funksion te Ambienteve Teknike Elektrik</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI TRAJTIMI AJRI - BLOKU OPERATOR MATERNITETI</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike ne NJESI TRAJTIMI AJRI - BLOKU OPERATOR SPITALI.( AHU )</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike Njesi Rikuperimi Ajri.Kontroll i gjendjes se ventilatoreve (kuzhineta,vibrime,zhurma)</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike Njesi Rikuperimi Ajri.Kontroll i gjendjes se ventilatoreve (kuzhineta,vibrime,zhurma)</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike ne Njesi Rikuperimi Ajri.Njesi Rikuperimi Ajri.Kontroll i gjendjes se ventilatoreve (kuzhineta,vibrime,zhurma)</p> <p>Kontroll dhe shërbim-riparime ,lyerje në: saraçineska kendore me hollandez 1/2" saraçineska kendore me hollandez 3/4" cope 75, saraçineska kendore me hollandez 1" (cope 11)</p> <p>F.V. POMPË RIQARKULLIMI (uji i ngrohtë sanitar)</p> <p>F.V Ventilator per nyjet sanitare Ø110 mm</p> <p>F.v. filtra për AHU 59x59x10, G3 i valëzuar me konnizë metalike</p> <p>F.v. filtra për AHU 59x50x10, G3 I valëzuar me konnizë metalike</p> <p>F.v. filtra për AHU 59x28x10, G3 I valëzuar me konnizë metalike</p> <p>F.v. filtra për AHU 59,3x28,7x29,, F7 me xhepa SP32RH00</p> <p>F.v. filtra për fancoil (dyscheme+tavanor)</p> <p>F.v. premistopë sipas faktit</p> <p>F.v. rripa transmisioni</p> <p>F.v. termoizolues për tubacionet e ajrit prej llamarine</p> <p>F.v. sensor i presionit të ulët të gazit</p> <p>F.v. sensor i presionit të lartë të gazit</p> <p>F.v. valvul sigurie 3/4 ne vakum</p> <p>F.v. nxjerrës ajri (çajruesa) rrjeti</p> <p>F.v. termostat komandimi për fan-coil</p> <p>F.v. maometër uji 10 bar</p> <p>F.V. kompresore DSH381A4APC per chillera</p> <p>F.V.termostat + rezistence 15 KW per akumul</p> <p>F.V.filter antibakterial per sallat e operacionit</p> <p>F.V.ene zgjerimi</p> <p>F.V. gaz R 410 A per kompresoret e chillerave</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike në POMPË E FURNIZIMIT ME UJË</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike në FILTER UV 30 m3/h</p> <p>Kontroll dhe shërbime teknike në FILTER RËRE</p> <p>Mirëmbajtje preventive pompë mbrojtjeje nga zjarri 7.5 kW, 3F, 2 1/2":</p> <p>Mirëmbajtje hidrantesh në kasete:</p> <p>F.V.filter ajri RS -11/15 RS-PRO 7,5 -11</p> <p>F.V.filter vaji RS -3/9 RS-PRO 7,5 -11</p> <p>F.V. ndares vaj/ajer RS-C 3/4 (NK-40)RS -PRO 7,5/11 (2NK)</p> <p>Lubrifikant per vida kompresor RENNEN D68 1lt</p> <p>F.V.elementet e filtrit AF0106 P prefilter</p> <p>F.V.elementet e filtrit AF0106M mikrofilter</p> <p>shërbim preventiv i kompresoreve</p> <p>Rakorde 241 1/4 6/8 pajisje</p> <p>F.V. A4/Z 1/4 3/8 kontraktues amerikan</p> <p>F.V. 6/8 R 15 M spiral bojeqielli</p> <p>Kontroll vizual i pompave të vakumit dhe bazamentit</p> |  |
|--|---|--|

|        |  |  |                      |
|--------|--|--|----------------------|
|        |  | Kontroll i presionit dhe mbushje me gaz R407 & R410A & R32 per kondicionere 9000/12000/18000 btu/h<br>Cmontim Furnizim Montim Elektrovalvol tre rugshe kondicioner 9000/12000 /18000 btu/h<br>Cmontim Furnizim Montim Kondesator 30 mikrofarad 9000/12000 /18000 btu/h<br>Cmontim Furnizim Montim Kondesator 60 mikro farad 9000/12000 /18000 btu/h<br>Zmontim Avolzhim Montim motorr kompresori kondicioneresh<br>Furnizim vendosje sistemim tub shkarkimi I kondensatit<br>Cmontim Furnizim Montim sensor ajri 9000/12000 /18000 btu/h<br>Cmontim Riparim Montim pakete kondicioneri 9000/12000/18000 btu<br>Mirembajtje e dhomes frigoriferike te morgut  |                      |
| NS-14A | Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj | Mirembajtja e gjeneratorit 350 KVA te Maternitetit<br>Mirëmbajtje preventive gjenerator 350 KVA – 4 herë në vit<br>Mirembajtja e gjeneratorit 630 KVA te spitalit 1<br>Furn.vend.filter ajri<br>Furn.vend.filter nafte<br>Furn.vend.filter vaji<br>Furnizim vaj motori per gjeneratorin<br>Furnizim bateri 125 A<br>Montim i paneleve diellore<br>F.V.bazament alumini per panelet diellore<br>Kontroll I siguresave DC dhe zevendesimi I tyre nese jane djegur<br>Pastrim me kompresor te inverteve te paneleve diellore<br>Pastrim larje me solucion perkates te paneleve diellore<br>Kontroll periodik te U.P.S. 160 KVA,<br>Kontroll periodik te U.P.S. 40 KVA<br>Kontroll periodik te U.P.S 200 KVA | A (0-20 milion lekë) |

**2.3.3** Një punësim minimalisht prej **8 (tetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar.

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me realizimin e suksesshem te sherbimit per objektin.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave te shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

c) C.V (përkatëse)

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e shërbimit objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

**2.3.5** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit te prokurimit, te përfshire ne licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

**Argumentimi:** Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

| STAF TEKNIK                           | NUMRI |
|---------------------------------------|-------|
| Instalues dhe riparues ngrohje-ftohje | 2     |
| Elektracist                           | 1     |
| Hidraulik                             | 1     |
| Instalues/Mirmbajtës ashensorësh      | 1     |
| Shofer                                | 1     |

**2.3.6/1** Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi,

*(Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

**Argumentimi:** Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

### **2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:**

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.*

*Pranohet dhe paraqitja e standardeve SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.7 gërma “a”-“b” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe

private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 50001-2018** është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018.

**2.3.8** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

| Nr | Emri i mjetit                               | Njësia | Sasia | Statusi                |
|----|---|--------|-------|------------------------|
| 1  | Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton | copë   | 1     | Në pronësi ose me qira |

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 10 të DST.**

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike , për realizimin e objektit prokurimi, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “**Spitali Rajonal Lezhë**”, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “*Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise*”, i ndryshuar.

*Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.*

*Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**